



**Raport Monitorimi për Planin e Veprimit 2019–2022 të
Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të
Burimeve Ujore 2018-2027**

Struktura:

1. Hyrje	Fq.4
2. Përmbledhje ekzekutive e SKMIBU	Fq.4
3. Plani i Veprimit 2019-2022	Fq.7
4. Monitorimi i implementimit të Planit të Veprimit 2019-2022	Fq.8
5. Vlerësimi i implementimit të Planin e Veprimit 2019-2022	Fq.10
6. Konkluzione dhe Rekomandime	Fq.19
7. Hapat e radhës	Fq.20

Lista e akronimeve

AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
AMBU	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
GT	Grupi Tematik
GMIP	Grupi për Menaxhimin e Integruar të Politikave
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MIBU	Menaxhim i Integruar i Burimeve Ujore
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PV	Plan Veprimi
SKMIBU	Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore

1. Hyrje

Raporti Monitorimit të Planit të Veprimit 2019–2022 të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (SKMIBU) 2018-2027, reflekton progresin e bërë dhe produktet e përfuara nga implementimi i aktiviteteve të Planit të Veprimit të SKMIBU-së për periudhën 2019-2022.

Plani i veprimit të SKMIBU parashikon afatin 2019-2022, pra edhe atë pjesë të aktiviteteve që duhet të kishin filluar zbatimin që në janar 2019. Duke qenë se Strategjia u miratua në shkurt të vitit 2018 dhe procesi i njohjes me përgjegjësitë nga instucionet, të cilat janë përcaktuar në të, zgjati përtej kësaj periudhe, është menduar që ky raportim të përfshijë edhe vitin 2022.

Ky raport analizon zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit 2019-2022; vlerëson sfidat, boshllëqet dhe joefikasitetin; reflekton mbi mësimet e nxjerra, pikat e forta dhe të dobëta të identifikuara gjatë zbatimit të këtij Plani Veprimi; jep informacion mbi rezultatet e zbatimit të aktiviteteve dhe përcakton komponentët që kanë nevojë për adresim me qëllim përmirësimin e implementimit për të aktiviteteve në planin e ardhshëm.

Raporti është përgatitur nga Sektori i Politikave dhe Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, Drejtoria e Menaxhimit Strategjik e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me insitucionet përgjegjëse për secilin aktivitet të parashikuar në Planin e Veprimit 2019-2022.

Megjithatë, në kuadër të raportit të monitorimit duhen theksuar edhe problematikat e hasura lidhur me marrjen e informacionit nga institucionet përgjegjëse për hartimin e raportit të Planit të Veprimit të SKMIBU. Duke qenë se ky plan përmban aktivitete për zbatimin e të cilave janë përgjegjëse insitucione të ndryshme të sektorit të ujit (ministri të linjës, agjenci në varësi të ministrive, kryeministrit etj.), procesi ka qenë kompleks dhe shpeshherë me vonesa nga ana e insitucioneve raportuese.

2. Përmbledhje ekzekutive e SKMIBU

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027 është hartuar në përputhje me Nenin 16 të ligjit nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar me ligjin nr. 6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, Vendimin e Këshillit Kombëtar të Ujit Nr. 1 (datë 17.02.2015), ‘Mbi përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjive Kombëtare të Ujit, Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore dhe Planeve të Menaxhimit për Rrezikun nga Përmytjet’ dhe Urdhrin e Kryeministrit Nr. 93 (datë 07.08.2012) që përshkruan Strukturën për Dokumentet Strategjike Sektoriale dhe Ndërsektoriale.

Kjo strategji është miratuar me VKM Nr. 73, datë 7.2.2018 për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018 – 2027. Referuar kapitullit 5, të dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi, “Raportimi, Monitorimi, dhe Vlerësimi” theksohet se raportet e monitorimit mbi zbatimin e SKMIBU-së, do të hartohen nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe më tej miratohen nga Këshilli Kombëtar i Ujit.

SKMIBU është hartuar në mënyrë të tillë që të ofrojë një kornizë për administrimin gjithëpërfshirës të burimeve ujore, e cila do të arrihet nëpërmjet:

- Përfshirjes së shumë sektorëve;

- Mbatjes së një fokusi të përgjithshëm;
- Një qasjeje dinamike më shumë se sa statike;
- Pjesëmarrjes aktive të grupeve të interesit.

Menaxhimi i integruar i burimeve ujore në vend synohet të arrihet nëpërmjet krijimit të kuadrit ligjor, ekonomik, institucional, teknik dhe social duke u bazuar në legjislacionin europian për mjedisin dhe parimet e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (MIBU).

SMIBU përcakton **5 objektiva strategjike** që kërkojnë një vëmendje të veçantë:



Figura 1. Aktivitetet kryesore të objektivave strategjike të SKMIBU 2018-2027

• **Sasia e ujit**

Ky objektivi strategjik ka të bëjë me sasinë e përdorimit të drejtë dhe të qëndrueshëm ndërmjet përdoruesve të burimeve ujore, që do të arrihet përmes masave teknike, të përkthyer në aktivitete konkrete të parashikuara në PV 2019-2022.

Për zbatimin e këtyre aktiviteteve janë përgjegjëse *Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit.*

Aktivitetet e parashikuara lidhen kryesisht me:

- përmirësimin e infrastrukturës së shpërndarjes së ujit dhe masat për ruajtjen e tij;
- masat për përballjen me ndryshimet klimatike;
- menaxhimi i burimeve ujore në nivel baseni ujqor;
- shpërndarja e barabartë e përfitimeve.

- ***Cilësia e ujit***

Objektivi cilësia e ujit, synon të parandalojë përkeqësimin e mëtejshëm të burimeve ujore, të mbrojtjes, sigurojë dhe përmirësojë gjendjen e ekosistemeve të trupave ujore; të përforcojë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, kryesisht nëpërmjet masave specifike që do të kontribuojnë në uljen e sasisë dhe nivelit të përqëndrimit të ndotësve që shkarkohen në mjediset ujore.

Gjithashtu ky objektivi ka si synim nxitjen e përdorimit të qëndrueshëm të ujit bazuar në mbrojtjen afatgjatë të burimeve ujore dhe në zbutjen e pasojave që kanë përmblytjet dhe thatësitat.

Për zbatimin e këtyre aktiviteteve janë përgjegjëse *Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit*.

Aktivitetet e parashikuara lidhen kryesisht me:

- vlerësimin dhe akreditim e laboratorëve ekzistues;
- monitorimin dhe përgatitjen e raporteve të monitorimit të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor;
- zhvillimin e databazës dixhitale për matjen e cilësisë së ujërave.

- ***Rreziqet nga uji***

Ky objektivi strategjik ka të bëjë me rreziqet që lidhen me ujin, siç janë thatësitat, pamjaftueshmëria e burimeve ujore dhe përmblytjet. Vunerabiliteti i lartë i burimeve ujore ndaj katastrofave natyrore, të cilat shkaktohen ose ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe sasinë e burimeve ujore na imponon t'i kushtojmë vëmendje të veçantë investimeve në infrastrukturën e parashikimit, parandalimit, mbrojtjes dhe menaxhimit ndaj katastrofave natyrore dhe kushteve ekstreme të motit.

Kjo arrihet nëpërmjet aktiviteteve konkrete të parashikuara në Planin e Veprimit, që lidhen kryesisht me vlerësime paraprake, harta rreziku si edhe plane kontrolli e menaxhimi të rreziqeve nga uji.

Për realizimin e aktiviteteve të planifikuara për përmbushjen e këtij objektivi, insitucionet përgjegjëse janë *Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile*.

Aktivitetet e parashikuara lidhen kryesisht me:

- vlerësimin fillestar dhe analizën e rrezikut nga kushtet ekstreme të motit (përmblytje, thatësira) për çdo ujëmbledhës;
- zbatimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse në zona mjedisore;
- hartimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile.

- ***Informacioni për ujin***

Ky objektivi synon gjenerimin e të dhënave dhe informacioneve të vazhdueshme, të krahasueshme, të përditësuara dhe të shkëmbyeshme mes insitucioneve përgjegjëse (dhe jo vetëm), në lidhje me politikën mbi ujin dhe me të dhënat/informacionin mbi të, të cilat do të përdoren në funksion të përmirësimit të politikave të menaxhimit të burimeve ujore. Aktivitetet e parashikuara në PV 2019-2022 për realizimin e këtij objektivi kanë si insitucion përgjegjës *Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit*.

Aktivitetet e parashikuara lidhen kryesisht me:

- përcaktimi i rrjetit të monitorimit të burimeve ujore;

- nxitja e kërkimeve shkencore;
- përmirësimi i aksesit në informacion dhe i prodhimit të të dhënave;
- krijimi i një kuadri institucional të përshtatshëm për ujin dhe klimën.

- **Menaxhimi i ujit**

Objektivi i cili synon menaxhimin e ujit në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse, që i shërben të gjitha interesave, ofron përfitime socio-ekonomike të barabartansipas parimeve të MIBU-së dhe BE-së për politikën për ujërat.

Insitucionet përgjegjëse për aktivitetet e parashikuara në këtë objektivi janë *AMBU dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë*.

Aktivitetet të cilat lidhen kryesisht me:

- zbatim i plotë i parimeve të BE-së për ujin dhe mjedisin;
- përcaktimi i qartë i roleve dhe përgjegjësi të insitucioneve kryesore të sektorit të ujit;
- nxitja e bashkërendimit dhe planifikimit ndërsektorial;
- hartimi i marrëveshjeve ndërkufitare;
- zhvillimi i instrumenteve ekonomike dhe financiare për rikuperimin e kostove;
- zhvillimit të kapaciteteve, rritja e integritetit, transparencës dhe pjesëmarrjes së grupeve të interesit në MIBU;
- monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të politikave për menaxhimin e ujit.

3. Plani i Veprimit 2019-2022

Rezultatet kryesore të pritshme nga implementimi i SKMIBU përfshijnë:

- Përdorim dhe shpërndarje në mënyrë efikase dhe të barabartë të ujit, si edhe përmirësim i efikasitetit të përdorimit të ujit në të gjithë sektorët me qëllim shfrytëzimin, riciklimin dhe ripërdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore;
- Reduktim të ndotjes nëpërmjet moslejimit të shkarkimeve të paligjshme dhe kufizimit të shkarkimeve të lëndëve kimike të rrezikshme në trupa ujorë (niveli i saktë i reduktimit të ndotjes do të jetë në funksion të sasisë dhe natyrës të këtyre shkarkimeve);
- Rritjen e qëndrueshmërisë dhe aftësisë për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve që vijnë nga katastrofat natyrore;
- Njohje të thellë të të gjitha burimeve ujore në vend, duke ofruar kështu një bazë njohurish publike për vendimet (politikën), lidhur me menaxhimin e integruar të burimeve ujore;
- Politika të qarta MIBU dhe zbatim të PMBU-së, nëpërmjet të cilave synohet të përcaktohen:
 - a) objektiva të matshme, në afate kohore të caktuara, në nivele të duhura,
 - b) përgjegjësitë e autoriteteve, duke u bazuar në një monitorim dhe vlerësim efikas.

Për të mundësuar implementimin e pesë objektivave strategjikë të SKMIBU-së dhe arritjen e rezultateve që priten nga menaxhimi i integruar i burimeve ujore, është hartuar një Plan Veprimi afatshkurtër 3-vjeçar i SKMIBU-së, i cili do të pasohet nga planet e radhës deri në përfundim të afatit të SKMIBU, 2018-2027.

Plani i Veprimit 2019-2022 është i përqëndruar tek rezultatet dhe vë në zbatim strategjinë dhe përcakton masat, rezultatet dhe aktivitetet për zbatimin e MIBU, ku për çdo një prej këtyre aktiviteteve është përcaktuar:

- insitucioni/et përgjegjëse;
- afati dhe kosto e zbatimit;
- përqindja e pritshme e realizimit të aktivitetit përgjatë viteve;
- indikator i matjes së progresit të aktivitetit.

Plani i Veprimit të strategjisë është i strukturuar në tre faza:

- **Faza e parë**, e cila përkon me aktivitetet e përcaktuara në Planin e Veprimit 2019-2022 dhe përfshin objektivat afatshkurtër të SKMIBU-së.
Përpjekjet do të përqëndrohen në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe procedurave për hartimin e politikave, strategjive, planeve dhe legjislacionit, si dhe në ngritjen e kapaciteteve të angazhuara në këto procese, duke përfshirë edhe monitorimin. Aktivitetet e Planit të Veprimit për këtë fazë janë të detajuara, me indikatorë konkret.
- **Faza e dytë**, e cila përkon me aktivitetet e përcaktuara në Planin e Veprimit 2023-2025, përfshin objektivat afatmesme të SKMIBU-së dhe synon konsolidimin e arritjeve të fazës së parë të zbatimit të strategjisë.
Ajo do të bazohet në vlerësimin e zbatimit të objektivave të periudhës së mëparshme dhe rivlerësimin e prioriteteve dhe do të përfshijë aktivitete të reja në fushat kyçe të menaxhimit të burimeve ujore, të tilla si përmirësimet në fushat ku progresi nuk ka qenë i mjaftueshëm në aspektin e përmbushjes së këtyre kërkesave dhe zbatimin e aktiviteteve të reja të propozuara.
Objektivat dhe indikatorët për këtë periudhë janë parashikuar në mënyrë të përgjithshme.
Kjo fazë do të shërbejë edhe për rishikimin e ndërmjetëm të SKMIBU, sikurëse edhe konkretizimin e indikatorëve specifik.
- **Faza e tretë**, e cila përkon me aktivitetet e përcaktuara në Planin e Veprimit 2025-2027, përfshin objektivat afatgjatë të SKMIBU dhe synon konsolidimin e arritjeve të dy fazave të mëparëshme.
Kjo fazë do të bazohet në vlerësimin e zbatimit të objektivave afatshkurtër dhe afatmesëm, si edhe rivlerësimin e prioriteteve, duke përfshirë aktivitete të reja në fushën e MIBU-së; të tilla si përmirësimet në fushat ku progresi nuk ka qenë i mjaftueshëm.
Kjo fazë do të shërbejë edhe për rishikimin e gjithë dokumentit dhe nisjen e punës për përditësimin e SKMIBU së ardhshme.

4. Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit 2019-2022

Elementet themelore të sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të SKMIBU janë:

- **Procesi:** Monitorimi dhe raportimi bazuar tek rezultatet - aktivitetet, produktet dhe treguesit në nivel rezultatesh dhe objektivash.
- **Raportimi:** Rolet dhe ndërveprimet e institucioneve pjesëmarrëse janë të përcaktuara. Institucionet përgjegjëse për rezultatet duhet ta dorëzojnë informacionin tek institucioni udhëheqës, AMBU.
- **Struktura e raporteve:** AMBU është përgjegjës për përgatitjen e formateve dhe të modeleve të raportimit; udhëzimet do të mbulojnë raportet 3-mujore dhe vjetore. Ato do të përfshijnë modelet e raportimit dhe udhëzimet se si të plotësohen ato. Fokusi i raportit 3-mujor do të përqëndrohet në zbatimin e aktiviteteve, duke nxjerrë në pah dhe shpjeguar

problemet dhe sfidat, si dhe rekomandimet se si të zgjidhen problemet. Fokusi i raportit vjetor do të përqendrohet në arritjet kryesore (politikat dhe niveli i ndikimit), dështime.

- **Përdorimi i informacionit:** Roli i institucionit udhëheqës - AMBU - është i përcaktuar, në monitorim dhe raportim është si më poshtë vijon:
 - ✓ Marrja e kontributeve 3-mujore dhe vjetore për raportet nga institucionet përgjegjëse për implementimin e aktiviteteve të përcaktuara në PV-në e SKMIBU;
 - ✓ Konsolidimi i informacionit 3-mujor dhe vjetor dhe paraqitja e tij në një raport të unifikuar për shqyrtim në organet drejtuese;
 - ✓ Krijimi i formularëve dhe i modeleve për udhëzimin e raportimit.

Struktura e monitorimit

Menaxhimi dhe monitorimi Planit të Veprimit të SKMIBU, do të realizohet në disa nivele (nga niveli politik e deri në nivel teknik sektorial).

- **Niveli i parë** - është GMIP Menaxhimi i Integruar i Ujit, si niveli më i lartë vendim-marrës për menaxhimin e burimeve ujore.
- **Niveli i dytë** – përbëhet nga institucioni kryesor - AMBU - që koordinon Planin e Veprimit të strategjisë me institucionet përgjegjëse dhe brenda drejtorive të saj, për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara. AMBU në bazë të raportimeve të insitucioneve përgjegjëse për secilin aktivitet, përgatit 2 lloje raportesh:
 - Raportet e monitorimit 3-mujor, të implementimit të aktiviteteve të PV-së, i cili i prezantohet insitucioneve përgjegjëse gjatë mbledhjeve të Grupit Tematik “Burimet Ujore”;
 - Raporti i monitorimit vjetor, të implementimit të aktiviteteve të PV-së, i cili prezantohet gjatë mbledhjes së GMIP “Menaxhimi i Integruar i Ujit”.
- **Niveli i tretë** – përbëhet nga Grupit Tematik “Burimet Ujore”, i cili organizon mbledhje periodike (siç parashikohen në kalendar), ku marrin pjesë përfaqësues të të gjithë insitucioneve kryesore në sektorin e ujit.




Figura 2. Struktura e Monitorimit të PV 2019-2022 të SKMIBU 2018-2027.

5. Vlerësimi i implementimit të Planit të Veprimit 2019-2022

5.1 Objektivi i përgjithshëm

Vlerësimi do të përfshijë periudhën nga viti 2019 deri në vitin 2022 dhe do të nxjerrë në pah arritjet e Planit të Veprimit gjatë tri viteve të para, në raport me rezultatet e pritshme dhe nivelin e arritjes së objektivave të përcaktuar; në mënyrë që të sigurohet informacioni i nevojshëm mbi progresin e bërë, mbi kufizimet e ndeshura, nxjerrjen e mësimave për të ripërcaktuar veprimet dhe ndërhyrjet për të optimizuar arritjen e objektivave dhe rezultateve.

Gjithashtu vlerësimi do të shërbejë për të përcaktuar një plan më të saktë veprimi për periudhën 2023-2025, vlerësim të nevojave financiare për zbatimin e strategjisë për periudhën e ardhshme.

Përveç kësaj synon të vlerësojë rëndësinë (ose nevojat për ndryshime) të objektivave të përcaktuara në Strategji, si dhe të vlerësojë "gjendjen faktike" të përgjithshme në vitin 2022 në mënyrë që të reflektojë çdo ndryshim të rëndësishëm të mjedisit që kërkon vëmendje strategjike të veçantë.

5.2 Objektivat specifike

Në këtë pikë trajtohen disa pyetje, përgjigjet e të cilave do të pasqyrojnë më qartë situatën lidhur me zbatueshmërinë e SKMIBU-së. Vlerësimi i këtij pyetësori do të kryhet nga AMBU, bazuar mbi rezultatet e raportimeve nga institucionet përgjegjëse të zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit të SKMIBU-së.

Objektivat specifike të vlerësimit do të jetë si më poshtë vijon:

5.2.1 Vlerësimi i efektivitetit të zbatimit të objektivave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit 2019-2022

Ky vlerësim do të bazohet mbi arritjet dhe përgjigjet e një pyetësi që lidhet me treguesit kryesore të SKMIBU-së, të cilët janë përzgjedhur nga kjo e fundit. Përdorimi i kësaj praktike do të mund të krijojë një strukturë krahasimore ku të mund të matet jo vetëm progresi i të gjithë koheshtrirjes së strategjisë, por edhe ai pjesor, në bazë vjetore.

5.2.1.1 A u arritën pritshmëritë e zbatimit të objektivave të SKMIBU dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit siç pritej gjatë 3 viteve të para?

Gjatë analizës së zbatueshmërisë së aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit 2019-2022, është përcaktuar përqindja e realizimit të aktiviteteve në bazë të objektivave të përcaktuara në SKMIBU, insitucioni përgjegjës dhe përqindja totale e realizimit të planit. Llogaritjet, e bazuara në informacionin e përcjellë nga insitucionet përgjegjëse për secilin aktivitet, tregojnë që është realizuar më shumë se 2/3 e PV 2019-2022, pra aktivitetet e parashikuara në PV janë realizuar në nivele të mira (bazuar në metodologjinë e cituar në Tabelën 2. *Kriteret e Vlerësimit të Performancës së Zbatimit të PV 2018-2022*), rrjedhimisht edhe pritshmëritë e zbatimit të objektivave të SKMIBU janë përmbushur.

5.2.1.2 A ishin aktivitetet e parashikuara, në Planin e Veprimit, të përshtatshme për të trajtuar problemet e menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe për të arritur objektivat e Strategjisë?

AMBU gjykon se, në përgjithësi duke marrë parasysh edhe periudhën në të cilën janë përcaktuar këto aktivitete, shkallën e njohurive dhe mënyrën e organizimit të sektorit të ujit në atë periudhë (2015-2018), aktivitetet e parashikuara në PV ishin të përshtatshme për të trajtuar një pjesë të problemeve të menaxhimit të integruar të burimeve ujore për të arritur objektivat e SKMIBU. Gjithashtu, objektivat strategjisë janë të përshtatshme dhe fleksibël për të adresuar të gjitha sfidat dhe problematikat e sektorit.

5.2.1.3 A e arritën aktivitetet e zbatuara nivelin e dëshiruar të performancës sipas çdo objektivi të strategjisë?

Në lidhje me performancën e aktiviteteve të zbatuara, është e pamundur të bëhet një vlerësim objektiv në tërësinë e zbatimit të aktiviteteve, kjo nisur nga fakti që shumica e insitucioneve përgjegjëse, nuk kanë raportuar shumë të dhëna specifike për t'u vlerësuar përgjatë viteve. Përsa i përket aktiviteteve të cilat janë përgjegjësi e AMBU, vlerësojmë që është arritur niveli relativisht i mirë i performancës, duke u nisur nga pritshmëritë fillestare për këto aktivitete dhe bazuar në buxhetin e alokuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë referuar kërkesave të AMBU-së në zbatim të objektivave të strategjisë.

5.2.1.4 Cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të evidentuara gjatë zbatimit të aktiviteteve të Planit të Veprimit?

Pikat e forta të identifikuara janë angazhimi i disa prej institucioneve përgjegjëse, të cilët janë munduar të përmbushin zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në PV, brenda afateve të përcaktuara në të.

- Përfshirja aktive e një pjese të institucioneve në raportimet e herëpashershme që kërkoheshin në kuadër të monitorimit të zbatimit të PV të SKMIBU-së.
- Në rastin e AMBU-së, një pjesë e madhe e aktiviteteve për të cilat ajo është përgjegjëse, janë përfshirë në politikat ekzistuese të PBA-së së institucionit, duke i konsideruar si pjesë të punëve operative të AMBU-së, në mënyrë që të reduktoheshin kostot e parashikuara në PV.

Pikat e dobëta të evidentuara, kryesisht gjatë procesit të raportimit të zbatimit të aktiviteteve të Planit të Veprimit, që kanë ndikuar ndjeshëm në mbarëvajtjen e procesit janë mungesa e buxhetit të nevojshëm, që lidhet drejtpërdrejt edhe me faktin që në disa raste aktivitetet e parashikuara në PV e SKMIBU nuk janë përfshirë në PBA-të e institucioneve përgjegjëse, gjë e cila ka rezultuar në mosrealizimin e aktiviteteve të caktuara.

- Edhe në rastet kur aktivitetet janë përfshirë në parashikimet e PBA-së (si në rastin e AMBU-së), nuk është alokuar buxheti shtesë për realizimin e aktiviteteve për të cilat është adresuar kërkesa, me referencat e miratuara në SKMIBU.
- Boshllëku i krijuar në marrjen e informacionit në kohën, formatin dhe në përmbajtjen e kërkuar, nga institucionet përgjegjëse për aktivitetet respektive.

5.2.2 Vlerësimi i rëndësisë së aktiviteve të përcaktuar në Planin e Veprimit

5.2.2.1 A janë objektivat e Strategjisë ende të rëndësishëm?

Objektivat strategjikë të përcaktuar në SKMIBU (sasia e ujit, cilësia e ujit, rreziqet nga uji, informacioni për ujin dhe menaxhimi i ujit), janë përcaktuar duke u mbështetur edhe në 4 shtyllat e përcaktuara në SKZHI 2015-2020, që janë: “Uji për njerëz”, “Uji për ushqim”, “Uji për mjedis” dhe “Uji për industrinë”. Rëndësia e burimeve ujore, rritja e konkureshmërisë për shfrytëzimin e tyre, nevoja jetike e njerëzve, mjedisit dhe ekonomisë për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ujit; risku mjedisor e social dhe kostot e larta ekonomike që shoqërojnë fenomenet ekstreme të motit, frekuenca e të cilave po rritet ndjeshëm në nivel global dhe rajonal janë më se të rëndësishëm dhe kanë një rol thelbësor në zhvillimin social ekonomik të vendit.

5.2.2.2 Sa efektive ishin ndërhyrjet/veprimet në arritjen e rezultateve të pritshme nga Plani i Veprimit dhe objektivat?

Duke u nisur nga përqindja e lartë e realizimit të aktiviteteve, dalim në përfundimin që ndërhyrjet/veprimet kanë qenë mjaftueshëm efektive. Por duhet të merret parasysh edhe mangësitë e hasura gjatë zbatimit, të cilat kanë ndikuar në një pjesë të rezultateve (si mungesa e fondeve, mungesa e informacionit të kërkuar, pandemia, etj.).

5.2.2.3 Cilat nga aktivitetet e PV-së janë ende të rëndësishëm dhe duhet të përfshihen në Planin e ri të Veprimit?

AMBU gjykon se aktivitetet e parashikuara në Planin e Veprimit 2019-2022, të cilat për arsye të ndryshme që nga problematikat e krijuara nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019, me situatën e pandemisë COVID-19 dhe mangësi të tjera të lindura gjatë zbatimit të aktiviteteve, nuk arritën të zbatohen plotësisht dhe janë vlerësuar ende të rëndësishme nga insitucioni përgjegjës duhet të mbarten edhe në Planin e Veprimit 2023-2025.

5.2.2.4 Cilat janë aktivitetet e reja/ qasja e re që do mundësojë arritjen e nivelit të dëshiruar të arritjeve dhe objektivave?

Duke u nisur nga problematika kryesore-mungesa e buxhetit, është parë e arsyeshme të bëhet një rikostim i aktiviteteve (të cilat lidhen me AMBU-në), me ndihmën nga ekspertë të projekteve nga të cilët AMBU është përfitues.

Gjithashtu, nisur nga evidentimi i mangësive në procesin e shkëmbimit të informacionit dhe raportimit të insitucioneve përgjegjëse, si një nga pikat e dobëta e cila ka ndikuar ndjeshëm në mbarëvajtjen e procesit, AMBU synon të ndryshojë qasjen e ndjekur në mënyrën e shkëmbimit të informacionit dhe të sigurojë përfshirjen dhe angazhimin aktiv të të gjithë insitucioneve përgjegjëse të aktiviteteve që do përfshihen në Planin e Veprimit 2023-2025, sepse suksesi i zbatimit të PV varet nga angazhimi dhe kontributi i insitucioneve përgjegjëse për zbatimin e veprimtarive të parashikuara.

5.2.3 Vlerësimi i efikasitetit të strukturës së menaxhimit të integruar të burimeve ujore, duke përfshirë këtu edhe bashkëpunimin ndërmjet insitucioneve përgjegjëse të sektorit të ujit;

5.2.3.1 Si e ka mbështetur ose penguar struktura aktuale e menaxhimit zbatimin e strategjisë dhe vendimmarrjen?

AMBU është insitucioni përgjegjës që ndjek zbatimin aktiviteteve të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore nga insitucionet përgjegjëse.

Instrumenti kryesor i përdorur nga AMBU për të thjeshtuar dhe realizuar procesin e raportimit të zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në PV janë mbledhjet e Grupit Tematik “Burimet Ujore”, duke u nisur nga fakti që në këtë grup tematik janë pjesëmarrëse të gjithë insitucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në PV. Kjo ka rezultuar një gjetje e suksesshme e AMBU-së dhe në përgjithësi ka ndikuar pozitivisht duke lehtësuar procesin e menaxhimit dhe monitorimit të zbatimit të strategjisë.

5.2.3.2 Eficenca në përmbushjen e detyrimeve, insitucioneve përgjegjës të sektorit të ujit në zbatimin e aktiviteteve të parashikuara dhe raportimin tek AMBU?

Një pjesë e insitucioneve kanë qenë plotësisht efektive, si në zbatimin e aktiviteteve, ashtu edhe në raportimin për zbatimin e tyre, në kohën e kërkuar.

Por për shkak të mungesës së raportimeve të plota dhe në kohën e duhur, nga insitucionet e tjera përgjegjëse, në lidhje me zbatimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit, krijon vështirësi në gjykimin e efikasitetit në përmbushjen e detyrimeve të këtyre insitucioneve në zbatimin e aktiviteteve.

Referenca e vlerësimit

I Keq	I Kënaqshëm	I Mirë	Shumë mirë

Objektivi Strategjik	Insitucioni Përgjegjës	Përqindja e Realizimit (%)	Vlerësimi
1. Sasia e Ujit	AMBU	59.25	I Mirë
	MIE	88.59	I Mirë
	MBZHR	90.63	I Mirë
	FSHZH	100	Shumë mirë
2. Cilësia e Ujit	AKM	66.7	I Mirë
	AMBU	50	I Mirë
3. Rreziqet që vijnë nga Uji	AMBU	41.6	I Kënaqshëm
4. Informacioni për Ujin	AMBU	56	I Mirë
	MTM	100	Shumë mirë
5. Menaxhimi i Ujit	AMBU	81.13	I Mirë
	MIE	100	Shumë Mirë

Tabela 1. Vlerësimi i performancës së secilit insitucion përgjegjës në zbatimin e PV 2018-2022

Përqindja	Kriteret e Vlerësimit të Performancës	Vlerësimi	Statusi	Niveli
0%	<p>-Nuk është raportuar nga insitucioni përgjegjës fillimi i zbatimit të aktivitetit;</p> <p>- Është raportuar nga insitucioni përgjegjës për zbatimin e aktivitetit që aktiviteti është pezulluar pa filluar zbatimin dhe/ose nuk ka filluar të zbatohet;</p> <p>-Deri në 2022, vitin e fundit të parashikuar për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në PV 2019-2022, përqindja e realizimit të aktivitetit nga insitucioni përgjegjës është deklaruar në vlerën 0%;</p> <p>-Deri në 2022, vitin e fundit të parashikuar për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në PV 2019-2022, përqindja e realizimit të objektivit strategjik, nga insitucionet përgjegjëse të aktiviteteve që parashikohen në këtë objektiv, është deklaruar në vlerën 0%;</p> <p>- Deri në 2022, vitin e fundit të parashikuar për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në PV 2019-2022, mesatarja e përqindjes së realizimit të aktiviteteve të parashikuara nga insitucioni përgjegjës është deklaruar në vlerën 0% ose nuk ka informacion;</p> <p>- Deri në 2022, vitin e fundit të parashikuar për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në PV 2019-2022, përqindja e realizimit të Planit të Veprimit 2018-2022 nga insitucionet përgjegjëse është deklaruar në vlerën 0%.</p>	I Keq	Nuk ka progres	1

1-49%	<p>-Deri në 2022, vitin e fundit të parashikuar për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në PV 2019-2022, përqindja e realizimit të aktivitetit nga insitucioni përgjegjës është deklaruar në vlerë më të vogël se 50%;</p> <p>-Deri në 2022, vitin e fundit të parashikuar për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në PV 2019-2022, përqindja e realizimit të objektivit strategjik, nga insitucionet përgjegjëse të aktiviteteve që parashikohen në këtë objektiv, është deklaruar në vlerë më të vogël se 50%;</p> <p>- Deri në 2022, vitin e fundit të parashikuar për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në PV 2019-2022, mesatarja e përqindjes së e realizimit të aktiviteteve të parashikuara nga insitucioni përgjegjës është deklaruar në vlerë më të vogël se 50%;</p> <p>- Deri në 2022, vitin e fundit të parashikuar për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në PV 2019-2022, përqindja e realizimit të Planit të Veprimit 2018-2022 nga insitucionet përgjegjëse është deklaruar në vlerë më të vogël se 50%.</p>	I Kënaqshëm	Në progres e sipër	2
50-99%	<p>-Deri në 2022, vitin e fundit të parashikuar për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në PV 2019-2022, përqindja e realizimit të aktivitetit nga insitucioni përgjegjës është deklaruar në vlerë më të madhe ose e barabartë me 50% dhe më të vogël se 100%;</p> <p>-Deri në 2022, vitin e fundit të parashikuar për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në PV 2019-2022, përqindja e realizimit të objektivit strategjik, nga insitucionet përgjegjëse të aktiviteteve që parashikohen në këtë objektiv, është deklaruar në vlerë më të madhe ose e barabartë me 50% dhe më të vogël se 100%;</p> <p>- Deri në 2022, vitin e fundit të parashikuar për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në PV 2019-2022, mesatarja e përqindjes së e realizimit të aktiviteteve të parashikuara nga insitucioni përgjegjës është deklaruar në vlerë më të madhe ose e barabartë me 50% dhe më të vogël se 100%;</p> <p>- Deri në 2022, vitin e fundit të parashikuar për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në PV 2019-2022, përqindja e realizimit të Planit të Veprimit 2018-2022 nga insitucionet përgjegjëse është deklaruar në vlerë më të madhe ose e barabartë me 50% dhe më e vogël se 100%.</p>	I Mirë	Ka shumë progres	3
100%	<p>-Deri në 2022, vitin e fundit të parashikuar për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në PV 2019-2022, përqindja e realizimit të aktivitetit nga insitucioni përgjegjës është deklaruar në vlerën 100%;</p> <p>-Deri në 2022, vitin e fundit të parashikuar për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në PV 2019-2022, përqindja e realizimit të objektivit strategjik, nga insitucionet përgjegjëse të aktiviteteve që parashikohen në këtë objektiv, është deklaruar në vlerën 100%;</p> <p>- Deri në 2022, vitin e fundit të parashikuar për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në PV 2019-2022, mesatarja e përqindjes së e realizimit të aktiviteteve të parashikuara nga insitucioni përgjegjës është deklaruar në vlerën 100%;</p> <p>- Deri në 2022, vitin e fundit të parashikuar për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në PV 2019-2022, përqindja e realizimit të Planit të Veprimit 2018-2022 nga insitucionet përgjegjëse është deklaruar në vlerën 100%.</p>	Shumë i mirë	Realizuar	4

Tabela 2. Kriteret e Vlerësimit të Performancës së Zbatimit të PV 2018-2022

5.2.3.3 A ka mbivendosje të kompetencave midis insitucioneve përgjegjëse të sektorit të ujit?

Në rastin e PV 2019-2022 nuk ka patur mbivendosje kompetencash, por është vënë re, përcaktimi jo i saktë i disa prej insitucioneve përgjegjëse për aktivitete të caktuara. Kjo ka sjellë në mosrealizimin e këtyre aktiviteteve të cilat në PV kanë një insitucion përgjegjës të caktuar, ndërkohë që si fushë përgjegjësie i përket një insitucioni tjetër (si në rastin e objektivit “rreziqet nga uji” ku një numër aktiviteteve i janë vendur AMBU-së në përgjegjësi, ndërkohë që mbulohen nga fusha e përgjegjesisë së AKMC-së).

5.2.3.4 A është i mjaftueshëm dhe i kënaqshëm kapaciteti i strukturave të MIBU?

Struktura e AMBU-së, e cila merret me monitorimin e zbatimit të SKMIBU-së, është Sektori i Politikave dhe Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, në Drejtorinë e Menaxhimit Strategjik. Kjo strukturë është tërësisht përgjegjëse dhe e dedikuar në ndjekjen e zbatimit të Strategjisë dhe koordinimin brenda AMBU-së, sikurse edhe mes insitucioneve të tjera. Nga ana tjetër insitucionet të cilat kanë detyrimin e zbatimit të objektivave të strategjisë do të duhet të harmonizojnë më mirë koordinimin e tyre të brendshëm në lidhje me këto objektivat, sikurse të aplikojnë kuminikimin vertikal hierarkik të nevojave, shqetësimeve apo vështirësive. Në të kundërt problematikat e hasura mbeten të izoluara në nivelin e përfaqësuesit në grupin tematik. Kjo mund të përmirësohet me një koordinim më të mirë apo rregullim të pjesshëm insitucional.

5.2.4 Analiza e zbatimit të Planit të Veprimit 2019-2022

Përqindja aktuale e realizimit të aktiviteteve të parashikurara në Planin e Veprimit 2019-2022 të SKMIBU, të raportuara nga insitucionet përgjegjëse për secilin nga pesë objektivat e përcaktuar në strategji, deri më Dhjetor 2022 është si më poshtë:

Përqindja e Realizimit të Planit të Veprimit 2019-2022					
Objektivi 1	Sasia e Ujit	Insitucioni Përgjegjës	AMBU	59.25%	86.17%
			MIE	88.59%	
			MBZHR	90.63%	
			FSHZH	100%	
Objektivi 2	Cilësia e Ujit		AKM	66.7%	62.5%
			AMBU	50%	
Objektivi 3	Rreziqet që vijnë nga Uji		AMBU	41.6%	41.6%
Objektivi 4	Informacioni për Ujin		AMBU	56%	89%
			MTM	100%	
Objektivi 5	Menaxhimi i Ujit		AMBU	81.13%	84.89%
			MIE	100%	

Tabela3. Përqindja e Realizimit të Objektivave Strategjik nëpërmjet realizimit të Planit të Veprimit 2019-2022

Plani i Veprimit 2019-2022 është realizuar në rreth 81.43% të tij.




Figura 3. Përqindja e Realizimit të Objektivave Strategjik nëpërmjet realizimit të Planit të Veprimit 2019-2022

Ku:

- për objektivin e parë të SKMIBU- Sasia e Ujit, në Planin e Veprimit 2019-2022 në total janë parashikuar 76 aktivitete. Insitucionet përgjegjëse për këtë objektiv janë përkatësisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për 57-të prej tyre, AMBU për 8 aktivitete, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Urban (MBZHR) 8 aktivitete dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) për 3 prej tyre. Përqindja e realizimit nga insitucionet përgjegjëse për secilin nga aktivitetet e parashikuara në Planin e Veprimit është 59.25% AMBU, 90.63% MBZHR, 88.59% MIE dhe 100% FSHZH;
- për objektivin e dytë të SKMIBU- Cilësia e Ujit, në Planin e Veprimit 2019-2022 në total janë parashikuar 4 aktivitete. Insitucionet përgjegjëse për këtë objektiv janë përkatësisht Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (1 aktivitet) dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM, 3 aktivitete). Përqindja e realizimit të këtij objektivi nga ana e MTM është 66.7% dhe 50% për AMBU, ndërsa totali i realizimit të objektivit 2 të SKMIBU është 62.5%;
- Për objektivin e tretë të SKMIBU, Rreziqet nga Uji, në Planin e Veprimit 2019-2022 në total janë parashikuar 7 aktivitete. Insitucionet përgjegjëse janë Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC). Në total përqindja e realizimit të këtij objektivi është 41.6%;
- për objektivin e katërt të SKMIBU- Informacion për Ujin, në Planin e Veprimit 2019-2022 në total janë parashikuar 4 aktivitete. Insitucionet përgjegjëse për këtë objektiv janë përkatësisht Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (1 aktivitet) dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) për 3 aktivitete. Përqindja e realizimit nga insitucionet përgjegjëse për secilin nga aktivitetet e parashikuara në Planin e Veprimit është 56% për AMBU dhe 100% për MTM. Në total ky objektiv është realizuar në vlerën 89%;
- për objektivin e pestë të SKMIBU- Menaxhimi i Ujit, në Planin e Veprimit 2019-2022 në total janë parashikuar 10 aktivitete. Insitucionet përgjegjëse janë Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (8 aktivitete) dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE, 2

aktivitete). Përqindja e realizimit nga insitucionet përgjegjëse për secilin nga aktivitetet që parashikohen nga PV-ja është 81.13% AMBU dhe 100% MIE. Në total ky objektiv është realizuar në vlerën 84.89%.




Figura 4 Përqindja e Realizimit të Objektivave Strategjik nga Secili Insitucion Përgjegjës Të PV 2019-2022

Nga 25 aktivitetet e parashikuara në PV 2019-2022, përgjegjëse për të cilat është AMBU, 15 prej tyre janë aktivitete për realizimin e të cilave është e nevojshme mbështetja buxhetore shtesë; rreth 19% e tyre (3 aktivitete) nuk janë realizuar në mungesë të alokimit të fondeve.

Përqindja e realizimit të aktiviteteve të parashikuara në PV në funksion të buxhetit (vetëm për AMBU)					
		Aktivitete pa fonde shtesë		Aktivitete me fonde shtesë	
		Nr.	%	Nr.	%
Objektivi 1	Sasia e Ujit	4	50	4	50
Objektivi 2	Cilësia e Ujit	2	50	2	50
Objektivi 3	Rreziqet që vijnë nga uji	1	14.3	6	85.7
Objektivi 4	Informacioni për ujin	0	0	1	100
Objektivi 5	Menaxhimi i ujit	6	25	2	75

Tabela 3. Përqindja e Realizimit të Objektivave Strategjike nga Secili Insitucion Përgjegjës Të PV 2019-2022

6. Konkluzione dhe Rekomandime

Nga raporti i monitorimit të Planit të Veprimit të SKMIBU, për periudhën 2019-2022, vlen të theksohet që gjatë vitit të parë të zbatimit të tij, në të gjithë objektivat dhe nën-objektivat ka filluar zbatimi i rreth 45% të aktiviteteve.

Ndër problematikat e këtij procesi, më së shumti kemi hasur me problematika në raportimin e realizimit të aktiviteteve apo masave nga institucionet përgjegjëse, të cilat kanë krijuar pengesa në analizimin dhe vlerësimin sasior të zbatimit të Planit të Veprimit.

Gjithashtu, përgjatë periudhës së zbatimit të këtij plani, jemi hasur me raportime në të cilat nuk janë plotësuar të gjitha zërat e pasaportës së indikatorëve (p.sh: emërtimi i aktivitetit sipas PBA, ekzekutimi i buxhetit të aktivitetit përgjatë viteve etj).

Një tjetër problematikë e hasur gjatë procesit të raportimit është edhe mungesa e indikatorëve konkretë, të mirëpërcaktuar dhe të matshëm për llogaritjen e saktë të nivelit/përqindjes së zbatueshmërisë së aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit 2019-2022.

Problematikë vazhdon të jetë edhe sigurimi i buxhetit për realizimin e aktiviteteve, gjë e cila pamundëson realizimin e aktiviteteve.

Lidhur me konkluzionet kryesore nga ky raport monitorimi përmendim:

1. Domosdoshmëria e përcaktimit të buxhetit të nevojshëm për financimin e aktiviteteve të parashikuara në PV dhe përfshirjes së tij në PBA-të e insitucioneve përgjegjëse.
2. Në rastet kur gjykohet e pamundur përfshirja në PBA-të e insitucionit, duhet vlerësuar mundësia e sigurimit të financimit nëpërmjet donatorëve, granteve etj.
3. Nevoja e ndërgjegjësimit të insitucioneve përgjegjëse për rëndësinë e raportimeve periodike të plota dhe duke respektuar afatet.
4. Përcaktimi i indikatorëve konkret dhe të matshëm për të gjithë aktivitetet, indikatorë që duhen propozuar nga insitucioni përgjegjës, që në fazën e parë të zbatimit të planit.
5. Shfrytëzimi i mbledhjeve të Grupit Tematik “Burimet Ujore”, për raportime periodike (3 mujore) nga të gjitha insitucionet, përgjegjëse për zbatimin e kësaj strategjie.
6. Plotësimi i raporteve periodike në të gjitha zërat e tij, në mënyrë që procesi i analizës dhe vlerësimit të zbatueshmërisë së planit të japë rezultate sa më të sakta, të besueshme dhe lehtësisht të matshme, referuar në projektet dhe investimet e realizuara.

7. Hapat e radhës

Siç u theksua edhe më sipër, përveçse si një pasqyrë e arritjeve të sektorit të ujit për periudhën 2019-2022, ky raport monitorimi synon të shërbejë edhe si udhëzues në përgatitjen e Planit të Veprimit 2023-2025 dhe të përcaktojë komponentët që kanë nevojë për adresim me qëllim përmirësimin e zbatimit të planit të ardhshëm.

Me përfundimin e procesit të raportimit të zbatueshmërisë së Planit të Veprimit 2019-2022 dhe fillimin e punës me hartimin e Planit të Veprimit 2023-2025, hyjmë në fazën e dytë (e cila është shpjeguar në pikën 3 të këtij raporti) të zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore.

Duke filluar me përcaktimin e strukturës dhe qasjes që do ndiqet për realizimin e planit. Për fillimin e punës me Planin e ri të Veprimit, insitucionet përgjegjëse janë vënë në dijeni nga AMBU, gjatë mbledhjes së tretë të Grupit Tematik “Burimet Ujore” me datë 12 Tetor. Në vijimësi të këtij procesi, AMBU i është drejtuar insitucioneve përgjegjëse, njëkohësisht edhe anëtare të GT “Burimet Ujore”, ku ka kërkuar bashkëpunimin dhe kontributin e insitucioneve në dërgimin e propozimeve për aktivitete të reja, që parashikohen në strategji/planet respektive, në lidhje me sektorin e ujit për periudhën 2023-2025.

Momentalisht, paralelisht me punën për raportin e monitorimit të Planit të Veprimit 2019-2022, AMBU, po punon me draftin e Planit të Veprimit 2023-2025, ku fillimisht po bëhet klasifikimi i aktiviteteve të parashikuara në PV 2019-2022 në bazë të përqindjes së realizimit të raportuar nga insitucionet përgjegjëse për të vlerësuar cilat nga aktivitetet që nuk janë zbatuar plotësisht janë akoma të rëndësishme dhe duhet të mbarten edhe në Planin e ri të Veprimit. Përveç këtyre, në planin e ri do të reflektohen edhe aktivitete të reja të propozuara nga insitucionet, të cilat i janë përgjigjur kërkesës së sipërpërmendur.

Hapi i radhës është shqyrtimi i aktiviteteve të propozuara dhe konkretizimi i punës së deritanishme me realizimin e Draft-Planit të Veprimit 2023-2025. Ky draft do t'i dërgohet në rrugë zyrtare insitucioneve përgjegjëse, me qëllim dhënien e komenteve dhe rekomandimeve nga insitucionet në lidhje me draftin.

Pas mbledhjes, analizimit dhe përpunimit të komenteve/reagimeve nga ana e insitucioneve përgjegjëse, AMBU do i vlerësojë dhe reflektojë këto komente në Planin e Veprimit 2023-2025.

Varianti final i draft-planit do t'i prezantohet insitucioneve në mbledhjen e Grupit Tematik “Burimet Ujore” dhe do i dërgohet në rrugë zyrtare.

Përpara se Plani i Veprimit 2023-2025, të fillojë zbatimin do të dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave, siç parashikohet në pikën 6 të nenit 16 të ligjit nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar me ligjin nr. 6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”.

Varianti i miratuar i Planit të Veprimit 2023-2025 do i dërgohet, në rrugë zyrtare, insitucioneve përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në këtë plan.

Fillimi i Fazës së Dytë

